



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 246, Datë 09.08.2023

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “EU GREEN ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.08.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1271/15 prot., datë 04.08.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “EU GREEN ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1271 prot., datë 18.04.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 195, datë 19.06.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.06.2023 dhe 21.06.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.06.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 231, datë 19.07.2023, vendosi të zgjasë afatin e vendimmarrjes përfundimtare deri në 30 ditë, për arsye të kohës së pamjaftueshme për të

shqyrtuar dokumentacionin plotësues të depozituar nga shoqëria me shkresën e datës 17.07.2023.

- Pas njoftimit nga ERE për vendimin nr. 231/2023, dhe dokumentacionin që mbetet ende për t'u plotësuar nga ky aplikim, shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1271/10 prot., datë 18.07.2023, nr. 1271/12 prot., datë 18.07.2023, nr. 1271/14 prot., datë 02.08.2023, depozitoi dokumentacion plotësues për këtë aplikim.
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar sipas Rregullores në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, pikës 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; pikës 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikës 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5- vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “EU GREEN ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI